

NGA: K.R.U.“HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A
Rr.WESLEY CLARK P.N.-Prizren
[Tel:029/244-150](tel:029/244-150)

PËR: MJETET E INFORMIMIT PRIZREN

DATA: 15.05.2018

LËNDA: NJOFTIM

Kompania Rajonale e Ujësjellësit dhe Kanalizimit “ Hidroregjioni Jugor “ Sh.A. Prizren,pas një pune intensive, ka arritur të aftësojë sistemin e ujësjellësit për fshatrat: Caparc , Shpinadi, Velezhë , Trepeticë, Smaq , Serbicë e Epërme dhe Novakë.

Në lokacionin e qujtur Novakë-Komuna e Prizrenit, kemi hapur pusin e ri, ku kemi siguruar sasi të ujit (**15-20 l**)/sec. Mostrat e marra për analiza Kimike dhe bakteriologjike, kanë rezultue me rezultate të pranueshme dhe si përfundim,uji mund të përdoret për pije .

Ky pus, është i destinuar për furnizim me ujë për pije për Qytetaret e Komunës së Mamushës. Sasia e ujit të pijes e siguruar nga ky pus, është i mjaftueshëm për Komunën e Mamushës (6500 banorë, nga 200 l/ditë për banorë).

Infrastruktura përcjellëse për furnizim me ujë, është e realizuar nga pusi deri te rezervuari, kurse për pjesën tjetër të infrastrukturës, nga Rezervuari deri në rrjetin e qytetit të Mamushës, duhet të sigurohen mjete për realizimin e rrjetit transportues të ujësjellësit.

Kompania Rajonale e Ujësjellësit “ Hidroregjioni Jugor “ sh.a. Prizren, me stafin profesional teknik, ka bërë inçizimni e gjendjes në teren dhe është përgatit Projekti ideor - paramasa dhe parallogaria për realizimin e këtij projekti,ku vlera është: 275,500.00 €.

Kompania Rajonale e Ujësjellësit “ Hidroregjioni Jugor “ sh.a Prizren, është në pritje të bashkëpunimit për të realizuar këtë projekt që është jetikë për Qytetarët e Komunës së Mamushës.

Besojmë se kjo informatë, për sigurimin e sasisë së ujit për qytetarët e Komunës së Mamushës, do të jetë nxitje për të gjitha instancat , duke filluar nga Komuna e Mamushës deri tek Kryeministri, për të siguruar mbështetje Materiale ,që sa më parë të fillohet në realizimin e ndërtimit të këtij projekti .

Me respekt,

K.R. U. “Hidroregjioni Jugor “ Sh.a Prizren